



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK

02/Nr. Prot. 2-180/6478
Nr. i faq. _____
Data 12 / 10 / 2020

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



Kuvendi i Komunës

Nr. 002/27/2020

Datë: 29.09.2020

Në bazë të nenit 12, pika b, paragrafi 12.4, nenit 40.2, shkronja a) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008); nenit 29, të Statutit të Komunës së Junikut, Kërkeses me nr. 17.09.2020 me nr. 2-155/5800, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 29.09.2020, nxjerrë:

V E N D I M

- I. Me këtë vendim miratohet kërkesa nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik për faljen e borxheve për vitin 2020 për të gjitha bizneset të cilat i paguajnë borxhet paraprake.
- II. Falja e borxheve konform paragrafit I të këtij vendimi behet për shkak të veshtiresive në fushen e biznesit që ka shkaktuar periudha e pandemisë – Virusi Sars Covid 19.
- III. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
4. Arkivi i Komunës së Junikut.



Adresa:

Tel.: +386 (0) 49 760 270

<http://rks-gov.net/junik>